



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 10 qershor 2010, në mbledhjen e tretë të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blekçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj, z. Radisav Peroviq, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agim Veliu, kryetar i Komunës, z. Hilmi Mehmeti, Policia Rajonale Kufitare - Veriu, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë-Podujevë, z. Muharrem Haziri, OSBE – Prishtinë, z. Driat Cerabregu, OSBE – Podujevë dhe z. Miroslav Mzourek, LMT – KFOR

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25 maj 2010

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i shqetësimeve për kalimin e vijës kufitare gjatë ardhje – vajtjes të vizitorëve tek të afërmit e tyre në lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergofc

z. Radisav Peroviq, theksoi se në lagjen e sekiraqëve jeton një numër i vogël i serbëve të cilët kryesisht janë të moshuar por edhe të sëmurë dhe se brenga e tyre më e madhe është se të afërmit e tyre nuk mund t'iu vijnë në vizitë për shkak të vështirësive me të cilat përballen për kalim të kufirit, edhe pse shtëpitë janë në afërsi të vijës kufitare.

Rruga nëpër të cilën kalohet ekziston sigurisht më se 100 vjet në të cilën frekuentimi i njerëzve është shumë i vogël dhe nga kjo nuk e kam të qartë përse të ndalohet kalimi nëpër atë rrugë aq më tepër kur dihet se njerëzit kanë prona dhe për arsyet e cekura nuk mund t'i punojnë ato.

Lidhur me këtë çështje kam biseduar me përfaqësues të strukturave të ndryshme dhe mund t'ju them se nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje për [problemin e cekur ekzistenca e jonë në atë lokalitet do të jetë e pamundur.

z. Agim Veliu, kryetar i Komunës, nënvizoi se shqetësimi të cilin e paraqiti parafolësi është shqyrtuar edhe me përfaqësuesit e KFOR-it, Policisë Rajonale Kufitare – Veriu dhe përfaqësuesin e komunitetit serb, është definuar problemi dhe është konstatuar se çështja e vijës kufitare nuk është në kompetencë të Nivelit lokal, përkatësisht Komunës dhe mbi këtë bazë jemi pajtuar që atë çështje ta adresojmë në organet kompetente mirëpo paraprakisht të shqyrtohet në Komitetin për Komunitete.

z. Hilmi Mehmeti, u pajtua me diskutimin e parafolësit dhe shtoi se është i gatshëm të përgjigjet në të gjitha pyetjet për të cilat janë të interesuar anëtarët e këtij Komiteti.

z. Burhan Blakçori, rikujtoi se kjo çështje është përmendur edhe në një mbledhje të mëparshme të këtij Komiteti dhe shtoi se i kuptojmë shqetësimet e atyre banorëve mirëpo duhet të kuptojmë edhe realitetin e ri të krijuar dhe se jemi të vetëdijshëm se rregullat për kalime kufitare janë të obliguara të respektohen. Mirëpo unë jam i mendimit se duhet të shikohet se në kuadër të suazave ligjore a ekziston ndonjë lehtësim eventual për zgjidhjen e këtij problemi.

z. Nebih Behluli, theksoi se e mbështet lëvizjen e lirë të të gjithë qytetarëve por gjithherë në respektim dhe përfillje të procedurave ligjore. Përndryshe, shtoi ky diskutues, jo larg atij lokaliteti është banja e Siarinës në të cilën më parë shumë shqiptarë kanë shkuar për shërim, mirëpo tash nuk shkojnë për shkak të ndjenjës së pasigurisë por edhe për shkak të disa rasteve të maltretimeve, por sikur të hapej ndonjë pikë kufitare një veprim i tillë do të kontribuonte në mënyrë reciproke dhe njëherit në zgjidhjen e këtij problemi.

z. Radisav Peroviq, theksoi se parafolësi sigurisht nuk është në dijeni të esencës së problemit dhe për të qartësuar dua t'ju them se djali im nga Medvegja duhet të shkojë në Nish , prej aty në Merdar dhe të vijë në shtëpi, pra në vend të 20 km. është i detyruar të kalojë 200 km.

E përsërisë edhe një herë se ne 8 serb të cilët jetojmë në atë lokalitet jemi pothuajse plotësisht të bllokuar, mirëpo unë gjithherë kam qenë tolerant dhe optimist se kjo çështje do të zgjidhet por ky optimizëm më është shuar me ndodhjen e incidentit më 23 janar 2010, kur pothuajse nga varrezat janë marrë 17 njerëz dhe në procedurë për kundërvajtje janë dënuar me nga 250,00 €.

Dua të them edhe këtë se vazhdimisht po prehet dhe po vidhet pylli dhe se për këtë deri tash askush nuk është përgjigjur, ndërsa nëse vjen në vizitë një i afërm i imi kjo paraqet problem, unë këtë nuk mund ta kuptoj.

Përndryshe as unë e askush tjetër nuk jemi kundër që çdo vizitori t'i kontrollohet dokumentacioni personal por jo edhe të maltretohet.

Në vazhdim, pas propozimeve të paraqitura, njëzëri u vendos që për këtë çështje me iu drejtuar Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës, përkatësisht Zyrës për Komunitete.

Shkresën në bashkëpunim me Shërbimin profesional të Kuvendit ta shkruan grupi në përbërje:

1. Burhan Blekçori,
2. Nebih Behluli dhe
3. Jahë Lahu

4. Të ndryshme

z. Miroslav Mzourek, nënvizoi se çështja për të cilën u debatua në pikën paraprake është problem i shprehur në gjithë pikën kufitare të Kosovës, pra ky nuk është problem vetëm i Komunës së Podujevës dhe se zgjidhja e kësaj çështjeje është interes në nivel të Kosovës. Përndryshe jam i mendimit se në asnjë mënyrë nuk do duhej të zvogëlohet rëndësia e këtij problemi andaj në këtë drejtim do të ishte mirë që shkresa për të cilën u vendos të përgatitet dhe të dërgohet sa më parë.

z. Arbresha Hetemaj, theksoi se në këtë Komitet po merremi vetëm me shqetësimet e komuniteteve pakicë derisa jemi në dijeni se në shumë lagje ku jeton komuniteti shumicë kanë probleme të theksuara.

Në vazhdim, njëzëri u vendos që anëtarët e këtij Komiteti në shoqërim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe Policisë Rajonale Kufitare, me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë dhe marrjes së informacioneve shtesë, më 17 qershor 2010 të vizitojnë lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergofc.

Mbledhja përfundoi në orën 12.05.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/186-06

Podujevë,

10 qershor 2010

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**